



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.59/2025

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë ka paraqitur ankesë kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 20.01.2025, mori këtë:

### V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.59/2025 e datës 17.01.2025, ashtu që subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënimi më gjobë në lartësi prej 3,500.00 (tremijepesëqind) euro.

II. Detyrohet Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

### A r s y e t i m

Me datë 17.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se në qytetin e Podujevës me datë 15.01.2024 në ora 18:00 në tubimin politik të subjektit Lëvizja Vetëvendosje (LVV) kryetari i kësaj partie Albin Kurti dhe kryeministri aktual gjatë fjalimit të tij ka bërë shkelje të rëndë të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, respektivisht nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.11, i cili shprehimisht thotë *“përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje*

*kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.*

Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se për ilustrim se çka ka thënë kryeministri Kurti në fjalimin e tij në Podujevë, të transkriptuar edhe në tekst e gjeni si në vijim:

*"Te dashur qytetaret te Llapit, LYDYKYHI - Lidhja Demokratike e Kosovës nuk është Lidhje, por është lodhje, dhe nuk është demokratike por është dokratike. E ne përgjithësi mendër methane opozita po i japin zor mule anej mule knej për vend te dyte, poget e kane pa edhe ata vet që s'ka ymyt, se qashtu qysh Shpejtimi i ka myt, Vetëvendosja po i myt cep me cep ne Republikën e Kosovës"*

Tutje parashtruesi i ankesës thekson, pra në rastin konkret - video te bashkëngjitur në CD mund ta dëgjoj Paneli edhe me audio dhe video, shihet qarta shkelja e rende dhe e pakontestueshme e Ligjit per Zgjedhjet e Përgjithshme, nenit 34 paragrafi 1, nen paragrafi 1.11, madje kjo është sjellje përsëritëse e kandidatit per kryeministër nga radhët e LVV, sepse për të njëjtin fjali ishte dënuar nga PZAP për fjalimin e tij në Pejë në shumë prej 3000 euro sipas Vendimit 30/2025, date 15.01.2025.

Sipas parashtruesit të ankesës, theksohet se duke u bazuar në gjithë këto prova kërkojnë nga PZAP-i si organ kompetent dhe i autorizuar që të shqiptoj masë më të lartë sanksionuese ndaj subjektit politik LVV, për shkeljen e përsëritur, që kandidati i tyre për kryeministër ka bërë gjatë fjalimit te tij në tubimin politik në Podujevë.

Më datë 17.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri më 18.01.2025 në ora 14:00.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 18.01.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe atë për faktin se duke u bazuar në legjislacionin zgjedhor dhe jo vetëm, duke u bazuar edhe në aktet tjera juridike të larta si Kushtetua e Kosovës dhe Konventat Ndërkombëtare me efekt direkt në legjislacionin pozitiv, konsiderojnë se nuk kanë të bëjmë me shkelje, për arsye se kryeministri Kurti, së pari përdor termin "Ldkyhi" pastaj këtij subjekti i drejtohet me emrin e saj zyrtar "LDK", ku konsiderojnë se kjo bënë pjesë në suazat e humorit dhe nuk gjen mbështetje në nenin e referuar nga subjekti ankues neni 34 par.1 nënpar.1.1 i Ligjit për Zgjedhje i cili flet për nxitjen e urrejtjes, akte të dhunës, nxitjes dhe shkelje të tjera të rënda, asnjëri nga këto veprime të ndaluara taksativisht me këtë pikë të nenit 34 nuk gjen mbështetje në fjalimet e kryeministrit Albin Kurti.

Tutje parashtruesi i ankesës thekson se humori në vetvete nuk përmban shkelje të tilla të pretenduara, pasi që në një shoqëri demokratike e cila respekton mendimet ndryshe nuk duhet ta ketë problem qasjen me humor ndaj një subjekti politik dhe aq më pak ta cilësoj të njëjtën si shkelje, pasi që atmosfera gjatë fjalimit tregon qartazi se nuk kemi të bëjmë me veprimet e ndaluara si dhuna, nxitja, provokimi apo veprimet analoge të përmendura në bazën ligjore nga subjekti ankues, konkretisht neni 34 i cili nuk sanksionon dhe nuk përmend humorin si shkelje. Po ashtu, në përgjigje në ankesë theksohet se lidhur me pretendimet dhe analogjinë e përdor nga LDK, se kinse njëherë

është marrë vendim lidhur me këtë term të përdorur nga kryeministri Albin Kurti, të njëjtit theksojnë se nuk kemi të bëjmë me praktikë të konsoliduar nga PZAP, për arsye se rastet janë substancialisht të ndryshme dhe se për këtë objekt ankese kemi të bëjmë me humor të pa sanksionuar dhe të garantuar me akte të larta juridike, për dallim nga rastet e kaluara ku pjesërisht PZAP-i gjeti shkelje pasi që pas përdorimit të termit "ldkyhi" kishte edhe shkelje tjera që lidhën me këtë deklaratë.

Në përgjigje në ankesë thuhet theksojnë se kemi të bëjmë me shprehje të mendimeve nga ana e kryeministrit Kurti siç garantohet me Kushtetutë kur thotë se LDK është dogmatike dhe e lodhur, duke mos e ofenduar dhe as nxitur askënd ashtu siç ata pretendojnë, madje fushata zgjedhore në përkufizimin e saj në nenin 3 të LZP shprehimisht garanton se subjektet politike mund të propagandojnë dhe avokojnë lidhur me qëllimin që ka fushata me mesazhet politike, si dhe tutje në përgjigje në ankesë theksohet, se duke elaboruar dispozitat ligjore mbi qëllimin e fushatës zgjedhore, e njëjta padyshim se ka qëllim që të fitohen sa më shume vota, dhe se në fjalimin e kryeministrit Kurti e që është objekt i kësaj ankese se "opozita ska ymyt" dhe "qysh i ka myt Shpejtimi në Llap" (fjala është për kryetarin e Podujevës nga rradhët e Vetëvendosjes), "Vetëvendosja po i myt cep më cep të Kosovës" (sllogani politik i VV në këto palë zgjedhje), cka arsyeton se fjala është për garën zgjedhore dhe jo për nxitje sic e quan ankuesi, fitorën e të cilit në zgjedhje lokale e ndërlihd figurativisht për fitoren në zgjedhje qendrore duke përdorur metodën e krahasimit për fitorën në nivel qendror, shto faktin se personat juridik në këtë rast subjektet politike nuk frymojnë e rrjedhimisht edhe nuk "mbyten" natyralisht, kjo qëndron në suazat e krahasimeve figurative që gjejnë mbështetje në raste të famshme të praktikës se GJEDNJ-së (shih: Loser v. Austria), 2011, rast ky që specifikisht ka vendosur theksin se satira dhe krahasimet figurative veçanërisht kur janë të drejtuara në politikë lejohen dhe nuk sanksionohen.

Nga rrethanat e rastit duke analizuar të gjitha provat një nga një dhe të gjitha së bashku kërkojmë nga Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, që kjo ankesë të hedhet poshtë si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli, pas shikimit të video incizimit të ofruar si provë materiale e cila është publikuar shihet se kryetari i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), - kandidati për kryeministër Albin Kurti në raport me subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka përdorur gjuhë fyese dhe denigruese duke nxitur urrejtje ndaj këtij subjekti politik, në atë mënyrë që përderisa i ishte drejtuar elektoratit të tije në Podujevë përdorë fjalët *"Te dashur qytetaret te Llapit, LYDYKYHI - Lidhja Demokratike e Kosovës nuk është Lidhje, por është lodhje, dhe nuk është demokratike por është dokratike. E ne përgjithësi mendër methane opozita po i japin zor mule anej mule knej për vend te dyte, poget e kane pa edhe ata vet që s'ka ymyt, se qashtu qysh Shpejtimi i ka myt, Vetëvendosja po i myt cep me cep ne Republikën e Kosovës"*.

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2024, me datë 14.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur ndaj subjektit politik LDK, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Në këtë rast është marrë për bazë kontekstin dhe qëllimin për të cilin është përdorur gjuha ndaj një subjekti politikë në garë, faktin që deklaratat janë bërë në miting publike, audiencën, andaj sipas Panelit përdorimi i gjuhës së tillë ndaj kundërshtarëve politikë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrimë përçmues ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektet politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyese, denigruese dhe urrejtëse, andaj sipas Panelit përdorimi i kësaj gjuhe në këtë rast konsiderohet si përkeqësim i klimës në të cilën duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe njëherit mund të rrisë tensione mes subjekteve politike. Nuk mund të konsiderohet që gjuha e tillë është përdorë në mënyrë humoristike, përkatësisht interpretimi humoristik e humb kuptimin marrë për bazë kontekstin që është përdorë dhe qëllimin e denigrimit dhe përçmimit të subjektit politikë në fjalë.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, pjesëmarrjen e subjektit në fjalë në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe të njëjtit subjekt politik për shkelje të natyrës së njëjtë i është shqiptuar gjobë nga PZAP-i, me Vendimin Anr.30/2025, të datës 15.01.2025.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të përgjigjes në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika l.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

Anr. 59/2025 më datë 20.01.2025

**Kryesues i Panelit**

Arsim Hamzaj



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.